

Falë USAID-it, gjejnë punë 75 të rinj të Kosovës

PRISHTINË, 2 TETOR ■ Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

“USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës. Pasi që e gjithë ekonomia e Kosovës po lëviz drejt shekullit XXI, konkurrenca në treg, zhvil-

limi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të reja, do të jetë kërkesë thelbësore. Ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Enver Hoxhaj tha se “qëlimi jonë si qeveri është që Republika e Kosovës të jetë një shtet i dijes dhe i kërkimit shkencor të cilat duhen të jenë patjetër në funksion të zhvilli-

mit ekonomik në Kosovë”. Dhe në funksion të qëndrueshmërisë kulturore në kuadër të kësaj ne si ministri kemi punuar shumë që shteti i Kosovës të jetë shtet i dijes. Ndërsa rektori i Universitetit të Prishtinës-së Mujo Rugova tha se Universiteti i Prishtinës me 70 njësi akademike dhe me 129 fusha studimi me nivel baqellor, master dhe doktoratur është duke bërë përpjekje për cilësinë e studimit në të gjitha fushat për të arritur në ni-

velin më të lartë dhe të krahasueshme me universitetet me vlerë në regjion dhe në Evropë, ai shtoi se është e domosdoshme që edhe më tutje të kemi mbështetje materiale, mbështetje morale tek institucionet sikurse janë USAID-i, WUS Austria dhe asociacionet tjera tha ai. Për t’iu ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit tha ai. Gjithashtu edhe Drejtori i KPEP-it

Mark Wood, tha se programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës, trajnimit dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për shkak se 16 studentëve u është ofruar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. ■ **Arta Beqiri**

03/11/2010, "BOTA 807"